KËRKESË
Nr. 634/7, datë 25.5.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, 'Ndërtimi i godinës së parkimit nëntokësor dhe i Parkut Çlodhës, Vlorë''', me vlerë totale paraprake të shpronësimit 7,228,689 (shtatë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "truall", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 7,228,689 (shtatë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I GODINËS SË PARKIMIT NËNTOKËSOR DHE I PARKUT ÇLODHËS, VLORË"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat e pasurisë			Tokë "truall"				Tokë "arë"				Ndërtesë soc.-ek			Objekt banimi				Vlera totale (lekë)	Shënime	Adresa e pronareve
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m^2	Sipërfaqja e shpronësuar (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë	Sip. totale m^2	Sipërfaqja e shpronësuar (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë	Sip. totale m^2	Sipërfaqja e shpronësuar (m^2)	Vlera sipas preventivit lekë	Sip. totale m^2	Sipërfaqja e shpronësuar (m^2)	Çmimi m^2	Vlera lekë			
1	Manushaqe Mezan Ilenja Arbi Ariela	Xhafer Safet Safet Safet Safet	Abazi Abazi Abazi Abazi Abazi	8602	33/12-T	Truall	400	400	10,903	4,361,200												4,361,200.00	Seksioni D-mungon skica e vendimit të gjykatës, si dhe certifikata e trungut familjar të Kozma Thanas dhe Josif Dodit. Nuk kanë firmosur të gjithë bashkëpronarët në shitje, seksioni E -e vlefshme për shpronësim.	Bashkia Vlorë
2	Manushaqe Mezan Ilenja Arbi Ariela	Xhafer Safet Safet Safet Safet	Abazi Abazi Abazi Abazi Abazi	8602	33/23	Truall	800	263	10,903	2,867,489												2,867,489.00	Seksioni D-mungon certifikata e trungut familjar të bashkëpronarëve të trashëgimlënësit seksioni E -e vlefshme për shpronësim	Bashkia Vlorë
3	Shtet	Shtet	Shtet	8602	28/149	Truall	6201	1593															Seksioni E-29 m^2 vijojnë në pas. me nr. 28/80/1, v. 119, f. 201	
4	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/28	Truall	2066	282															Seksioni C-VKM Nr 265 dt 09/05/2025 për të drejtën e administrimit/përdorimit-Fondi Shqiptar I Zhvillimit.	
5	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/25	Truall	730	28.5															Seksioni C-VKM-ja nr. 265, datë 9.5.2025 për të drejtën e administrimit/përdorimit-Fondi Shqiptar i Zhvillimit.	
6	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/29	Truall	426	426															Seksioni C-VKM-ja nr. 265, datë 9.5.2025 për të drejtën e administrimit/përdorimit-Fondi Shqiptar i Zhvillimit.	
7	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/34	Truall	6142	6142															Seksioni C-VKM-ja nr. 265 datë 9.5.2025 për të drejtën e administrimit/përdorimit-Fondi Shqiptar i Zhvillimit.	
8	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/33/1	Truall	1066.7	1066.7															Seksioni C-VKM-ja nr. 265, datë 9.5.2025 për të drejtën e administrimit/përdorimit-Fondi Shqiptar i Zhvillimit.	
	SHUMA TOTALE																					**7,228,689.00**		